



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, datë 10.02.2025, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Dhënien e autorizimit të shoqërisë “Maxcom” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve online, mbështetur në rrjet IP (IPTV) “Maxcom”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. (Vendim nr. 11, datë 10.02.2025)
2. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Click.al” sh.p.k.(ish shoqëria “INET” sh.p.k.), për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.  
-Pranimin e kërkesës të shoqërisë “Click.al” sh.p.k.(ish shoqëria “INET” sh.p.k.), autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor, për ndryshimin e emërimit të subjektit tregtar nga “INet” sh.p.k., në “Click.al” sh.p.k.(Vendim nr. 12, datë 10.02.2025)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 10 Shkurt 2025